



ASSOCIATION OF ALBANIAN MUNICIPALITIES
SHOQATA E BASHKIVË TË SHQIPËRISË



Udhëzues për bashkitë

PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE CIVILE

Tiranë, 2018



Ky botim u përgatit nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë dhe me mbështetjen e Fondacionit Hanns-Seidel, Shqipëri.



ASSOCIATION OF ALBANIAN MUNICIPALITIES
SHOQATA E BASHKIVE TË SHQIPËRISË



Ky publikim reflekton rekomandime dhe udhëzime të Shoqatës së Bashkive dhe jo detyrimisht të Fondacionit Hanns-Seidel Shqipëri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	5
Kuadri ligjor dhe institucional	9
Seksioni 1: Zhvillimi i Programit të Menaxhimit të Emergjencave Bashkiake	18
Seksioni 2: Hapat dhe procesi për të shkruar një plan	25
Hapi 1: Diskutimi, trajtimi dhe vendimi i këshillit bashkiak	25
Hapi 2. Formimi i një komisioni të përhershëm të këshillit	27
Hapi 3. Koordinator i Menaxhimit të Emergjencave dhe Komisioni për Planifikimin e Menaxhimit të Emergjencave	27
Hapi 4. Cakto qartë rolin dhe përgjegjësitë e Drejtorisë/ Sektorit të Emergjencave Civile në Bashki	30
Hapi 5: Kryej vlerësimin e rrezikut	30
Hapi 6. Përcaktoni burime për të cilat keni nevojë	32
Hapi 7. Hartoni Planin e Emergjencave	33
Hapi 8: Trajnimi	34
Hapi 9. Testoni planin	34
Hapi 10. Përditësimi i Planit dhe Informimi i Qytetarëve	35
Seksioni 3: Veprimtaria e Komisionit Vendor në situata të Emergjencave Civile	45



Procedurat e emergjencës	61
Hapi 1: Kryeni shpërdarjen e punëve	61
Hapi 2: Aktivizimi i Komisionit Vendor	61
Hapi 3: Shpërndarja e KV	64
Përgjegjësitë e Anëtarëve të Ekipit të KV	64
Drejtuesi i Komisionit Vendor	64
Përfaqësuesit e shërbimit së mbrojtjes nga zjarri	66
Përfaqësuesi i policisë	67
Përfaqësuesi i agjencisë për shërbimet sociale emergjente	68
Përgjegjësitë e Strehimit	69
Përgjegjësit e ushqimit	69
Përgjegjësit e Veshjeve	70
Regjistrat e reagimit në rastet e emergjencë	70
Seksioni 4: Komunikimet në raste krizash	71
Seksioni 5: Shërbimet Sociale Emergjente	72
Seksioni 6: A jeni të pregatitur? Ushtrime për Emergjencat Bashkiake	75
Shtojcat	78
Shtojca A: Kuadri Ligjor për Emergjencat Civile	79
Shtojca B: Shembull i Marrëveshjes së Ndihmës së Ndërsjelltë	81
Shtojca C: LISTA E KONTROLLIT TË SHËRBIMIT TË QENDRËS SË PRITJES	85



HYRJE

Pse nevojtet një udhëzues për përballimin e emergjencave në nivel vendor?

Të gjitha Bashkitë përballen me emergjenca. Në shekullin e 21-të ne jemi më të prekur nga ndryshimet klimaterike, ngrohja globale, e jo vetëm, që sjellin përmbytjet dhe dukuri të tjera që shkaktojnë dëme në infrastrukturë dhe njerëz.

◆ *Bashkia nuk është immune ndaj këtyre kërcënimeve.*

Shumica e emergjencave civile menaxhohen pjesërisht në nivel lokal nga njësi të shërbimit të emergjencës siç janë sektorët apo drejtoritë e emergjencave civile në bashki, ambulancat, shërbimi zjarrëfikës dhe policia. Megjithatë, një emergjencë në shkallë më të gjerë kërkon më shumë burime dhe personel sesa mund të përballojnë strukturat e shërbimit të emergjencës përmendur më sipër. Për të qenë në gjendje të përgjigjen dhe kordinohen në mënyrë efektive në rast emergjence, është e domosdoshme që bashkitë të zhvillojnë një program gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave.

Kjo është mëse e nevojshme tashmë që pas reformës territoriale dhe Ligjit për Vetqeverisjen Vendore 139/2015, Neni 29 i cili kalon në bashki funksionet në fushën e sigurisë publike duke rritur përgjegjësitë e bashkive për planifikimin dhe menaxhimin e situatave emergjente.



Elementi kyç i gatishmërisë për përballimin e emergjencave është hartimi i planit të menaxhimit të emergjencave bashkiake. Gjatë hartimit dhe miratimit të një programi emergjence, është i nevojshëm angazhimi i strukturave të bashkisë dhe të zgjedhurve vendorë, marrja e kontributit dhe mbështetja nga agjensi të tjera mbështetëse që do të marrin pjesë në rast të nevojës për një reagim urgjent. Sapo të miratohet plani, është e nevojshme që ky plan të testohet për të siguruar funksionimin e tij si dhe për të qartësuar personelin e emergjencave civile me rolet e tyre.

Njësia e emergjencave civile në bashki është njësia kyçe që kordinon trajnimet dhe dhënien e ndihmës në të gjitha aktivitetet në spektrin e menaxhimit të emergjencave duke:

- punuar drejtpërsëdrejti me të gjitha struktura të tjera bashkiake;
- bashkëpunuar me agjencitë vullnetare;
- koordinuar me strukturat rajonale dhe qendrore,

për të siguruar udhëzimet dhe ekspertizën e kërkuar për bashkinë.

Miratimi dhe testimi i planit të emergjencës është hapi i parë për tu kryer sa më shpejt të jetë e mundur. Fatkeqësitë natyrore janë kryesisht të papritura, kështu që është e rëndësishme të kemi një plan të miratuar përpara këtyre fatkeqsive. Planifikimi përparak siguron që bashkia ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme



për t'u përgatitur për një emergjencë dhe zvogëlon dëmet në njerëz apo në infrastrukturë.

Element kyç i gatishmërisë për emergjenca është zhvillimi i një programi bashkiak të menaxhimit të emergjencave.

- ◆ Në të 61 bashkitë e vendit duhet të organizohet java e gatishmërisë së Emergjencave Civile (psh. gjatë javës së dytë të tetor/maj). Kjo është një mundësi dhe kohë ideale që bashkitë të punojnë për azhornimet e planifikimit dhe rivlerësimit të punës së tyre, dhe të demonstrojnë kompetencat dhe fuqinë për të përballuar situata emergjente.

Në rastin e Shqipërisë, arsyet për përgatitjen e këtij udhëzuesi janë disa. Së pari, kjo guidë synon t'ju shërbejë bashkive të reja post reformë, të cilat duhet të marrin përgjegjësi mbi vete për emergjenca civile në çdo kohë, t'i orientojë ato drejt pritshmërive qytetare për të pasur rol parësor dhe vendimtar në çështje të emergjencave civile, ngritjes së strukturave të qëndrueshme, qendra të shpëtimit dhe evakuimit si dhe tërë mekanizmit zinxhir për një sistem eficient në raste të emergjencave civile vendore.

Nga ana tjetër, referuar dhe praktikave në vendet e zhvilluara lidhur me menaxhimin e emergjencave civile, udhëzuesi vë theksin tek roli dhe përgjegjësitë e përbashkëta të Kryetarëve dhe këshillave bashkiakë. Vetëm me bashkëpunim, përfshirje në proces dhe vendimarrje të këshillit mund të sigurohet ecuri dhe





sukses në menaxhimin e emergjencave civile të çdo rasti, qoftë ky i izoluar apo i përhapur.

Gjithashtu, ky udhëzues mund të përdoret dhe zbatohet nga çdo organizatë/institucion që merr dhe ka përgjegjësi të përballimit të emergjencave civile. Ky udhëzues tregon hapat e përgatitjes së planit dhe të marrjes së përgjegjësive në funksion të dhënies dhe ofrimit të shërbimeve të emergjencës, ndaj kujtdo që ndodhet në situatë krize dhe emergjence. Parimet, rrugët, rregullat e përshkruara në këtë udhëzim mund të përshtaten sipas rastit dhe natyrës të bashkisë apo institucionit që do të ngarkohet për kryerjen e detyrave të caktuara në përballimin e emergjencave civile.

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Kuadri ligjor dhe ai institucional për përballimin e emergjencave civile parashikon ndërtimin e një rrjeti kombëtar të institucioneve dhe rolet përkatëse të tyre në rast të një emergjence civile. Pjesa e madhe e këtij legjislacioni është hartuar para miratimit të ndarjes së re territoriale dhe më e rëndësishmja para kalimit të mbrojtjes civile si funksion i bashkive, që ndodhi me miratimin e Ligjit për Vetqeverisjen Vendore, nr. 139/2015.

Për këtë arsye, ne do të shohim kuadrin ligjor në rend kronologjik, duke ju dhënë përparësi legjislacionit të miratuar pas reformës territoriale, por gjithsesi do të përfshijmë dhe aktet ligjore më të hershme duke analizuar rolin e bashkive sipas këtij legjislacioni.

Më konkretisht, sipas nenit 29 të Ligjit për Vetqeverisjen Vendore, bashkitë janë përgjegjëse për garantimin e këtyre funksioneve në fushën e sigurisë publike:

1. Mbrojtjen civile, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
2. Garantimin e shërbimit të zjarrfikësve, në nivel vendor, dhe administrimin e strukturave përkatëse, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.



3. Garantimin e mbarëvajtjes së marrëdhënieve në komunitet, parandalimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve në komunitet.
4. Parandalimin e kundërvajtjeve administrative, forcimin, inspektimin dhe monitorimin e zbatimit të rregulloreve e të akteve të njësive të vetëqeverisjes vendore brenda juridiksionit të tyre vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Strategjia Ndërsektoriale Për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, miratuar më 29 korrik 2015 përmend në fakt nevojën për ndërhyrje dhe azhornim të legjislacionit përkatës në fushën e qeverisjes vendore për tju përshatur rrethanave dhe kushteve të reja në qeverisjen vendore.

Strategjia ka parashikuar tre fusha kryesore:

- MBROJTJA KUNDRA ZJARRIT: Bashkive ju ka kaluar si funksion i vetë funksioni i shërbimit të mbrojtjes kundër zjarrit në nivelin vendor, siç shpjegohet më poshtë.
- MBROJTJA CIVILE: Strategjia dhe ligji i ri për mbrojtjen civile do të rishikojnë dhe përmirësojnë kompetencat dhe rolin e autoriteteve vendore në fushën e mbrojtjes civile me qëllim rritjen e efikasitetit të strukturave në mbrojtje të jetës dhe pronës së qytetarëve. Ligji i ri për emergjencat civile ende nuk hartuar dhe miratuar, por puna për hartimin do të nisë së shpejti.



- POLICIA BASHKIAKE Policia bashkiake do të suprimohet si strukturë e qeverisjes vendore. Funkcionet ligjzbatuese të policisë bashkiake do t'i kalojnë Policisë së Shtetit, e cila do të jetë përgjegjëse për zbatimin e urdhrave administrativë të kryetarëve të bashkive.

Akti pasues ligjor është **Vendim** i Këshillit të Ministrave, Nr. 965, datë 2.12.2015 "**Për Bashkëpunimin Ndërinstitucional të Strukturave të Drejtimit, në Rastet e Emergjencave Civile dhe Krizave**". Ky Vendim nis me rishikimin e mekanizmit të emergjencave civile duke bërë disa ndryshime të rëndësishme. Vendimi ngre Komitetin e Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave, i cili është është organi më i lartë për koordinimin e veprimeve të institucioneve shtetërore e subjekteve private dhe të burimeve materiale e financiare për përballimin e emergjencave civile e të krizave. Drejtues të pushtetit vendor janë anëtarë të këtij Komiteti.

Për nivelin rajonal dhe vendor, vendimi parashikon:

Strukturat e Planifikimit dhe të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në Nivel Rajonal dhe Vendor:

Në përbërje të strukturës së administratës së Prefektit ngrihet sektori i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile dhe krizave.

- Në përbërje të organikës së bashkive planifikohen struktura të përhershme të



planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile dhe krizave, si më poshtë vijon:

- për bashkitë qendër qarku, ngrihet strukturë në nivel drejtorie;
- për bashkitë e tjera, ngrihet strukturë në nivel sektori.

Sigurisht që akti ligjor më i rëndësishëm mbetet **Ligji** Nr. 8756, datë 26.3.2001, "**Për Emergjencat Civile**", qëllimi i të cilit është:

Planifikimi dhe përballimi i emergjencave civile janë detyra të shtetit shqiptar që synon:

- a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;
- b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;
- c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë



kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Në zbatim të nenit 16, të Ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001, "Për Emergjencat civile", i ndryshuar, kryetari i bashkisë është përgjegjës për planizimin dhe përballimin e emergjencave civile në bashkinë përkatëse. Në interpretim të këtij Ligji dhe Vendimit të sipërpërmendur, drejtoria/sektori në bashki do të ketë këtë rol:

- Drejtoria/Sektori e Emergjencave Civile është përgjegjëse për mirëadministrimin e çdo çështje që lidhet me menaxhimin e rasteve të emergjencave civile dhe rastet kur evidentohen situata emergjente, duke marrë masat e duhura parandaluese dhe masa konkrete për minimizimin e pasojave, nëpërmjet përdorimit eficient dhe efikas të burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion të saj.
- Drejtoria/Sektori e Emergjencave Civile është përgjegjëse për zbatimin e planeve të emergjencës në të gjithë territorin e Bashkisë, si dhe për bashkërendimin e punës me sektorë të tjerë apo organizma joqeveritare e vullnetare, subjekte të ndryshme privatë dhe shtetërore, qytetarë, në funksion të gjetjes së zgjidhjeve të duhura dhe përballimit me sukses të situatave emergjente.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 17, të Ligjit nr. 8756, dt. 26.03.2001, "Për Emergjencat civile", i ndryshuar, në çdo bashki, nën drejtimin e kryetarit të bashkisë,



krijohet komisioni vendor për emergjencat civile. Roli i këtij komisioni është planifikimin, kordinimin dhe menaxhimin e emergjencave civile në territorin e bashkisë dhe mbledhet jo më pak se një herë në tre muaj në situata normale, ose rast pas rasti sipas nevojës, si dhe qendron i mbledhur kur shfaqen situata të emergjencave civile.

Detyrat e komisionit janë:

- Komisioni i planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile në nivel bashkie planifikon, organizon, koordinon dhe kontrollon të gjithë masat parandaluese, lehtësuese dhe rehabilituese për përballimin e emergjencave civile në territorin e bashkisë;
- Komisioni miraton planet e përballimit të emergjencave civile në territorin e vet dhe i dërgon ato për aprovim e koordinim tek Prefekti i Qarkut;
- Komisioni harton dhe miraton strategjinë për reduktimin e riskut të fatkeqësisë për territorine e bashkisë përkatëse;
- Komisioni bashkërendon veprimtaritë për organizimin dhe pajisjen e forcave të ndërhyrjes në raste emergjente.

Ligji nr. 152/2015, "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin" përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat, të drejtat, statusin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në Republikën e Shqipërisë, si dhe rregullon veprimtarinë, marrëdhëniet e punës, garantimin e karrierës dhe vazhdimësinë në detyrë të punonjësve të këtij shërbimi.



Sipas këtij ligji, në nivel vendor organizohet drejtoria ose sektori i shërbimit të MZSH-së në varësi të kryetarit të bashkisë. Ajo përfaqëson strukturën bazë operuese dhe inspektuese në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në territorin që ka në juridiksion. Çdo bashki duhet të mbulojë territorin e saj me shërbim zjarrfikës, me stacione të kompletuara me personel, automjete dhe pajisje zjarrfikëse. Stacioni i shërbimit të MZSH-së është njësi operuese dhe inspektuese në varësi të shefit të sektorit të shërbimit të MZSH-së dhe ngrihet në çdo bashki, duke zbatuar standardin 1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë. Çdo stacion duhet të ketë jo më pak se 14 zjarrfikës, personel profesionist.

Më tej, ligji përcakton dhe detyrat konkrete të Kryetarit të Bashkisë, në Nenin 9, si më poshtë:

Kryetari i bashkisë ka këto përgjegjësi:

- a) merr masa për ngritjen dhe kompletimin me mjete e pajisje të stacioneve për fikjen e zjarreve dhe shpëtimin, të shërbimit të MZSH-së në territorin e bashkisë, sipas standardeve e normave në fuqi;
- b) planifikon fondet e shërbimit të MZSH-së, nga buxheti i bashkisë, për çdo vit;
- c) siguron gatishmërinë e përhershme të stacioneve të shërbimit zjarrfikës me automjete, pajisje speciale, personel zjarrfikës dhe i vë ato në dispozicion për shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin jetës, pronës, në çdo rast aksidenti, incidenti apo fatkeqësie dhe emergjencash të ndryshme në territorin e bashkisë;



ç) kërkon dhe detyrohet të japë ndihmë me personel, automjete e pajisje nga stacionet zjarrfikëse të tij, nga/për bashkitë fqinje ose më gjerë, në raste zjarresh masive, emergjencash dhe fatkeqësish të tjera;

d) bashkërendon veprimet e shërbimit zjarrfikës me forcat e tjera operuese që gjenden e veprojnë në territorin e bashkisë;

dh) merr masa për mbajtjen në gjendje funksionimi të rrugëve të kalimit, për automjetet dhe pajisjet zjarrfikëse;

e) kërkon nga institucionet përgjegjëse kompletimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, në objektet e çdo lloji, pyjet, kullotat etj., që gjenden në territorin e bashkisë;

ë) kërkon instalimin dhe kompletimin me sisteme hidrike funksionale për shërbimin e MZSH-së, konform normave dhe standardeve në fuqi, në gjithë territorin e bashkisë;

f) kërkon për çdo objekt, për miratimin e lejeve zhvillimore/ndërtimore, projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

g) jep leje zhvillimi/ndërtimi dhe akte shfrytëzimi të strukturave ndërtimore vetëm pas plotësimit të rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të përcaktuara në këtë ligj;

gj) planifikon fonde për trajnimin, kualifikimin periodik dhe rritjen e aftësive profesionale të personelit zjarrfikës që ka në juridiksion;



h) siguron, nëpërmjet mjeteve të informimit publik që ka në dispozicion, informimin për edukimin e komunitetit me njohuritë dhe masat e mbrojtjes kundër zjarrit;

i) vendos lidhje dhe bashkëpunon me partnerë ose dhurues të shteteve të tjera, për të siguruar asistencë teknike, kualifikime e specializime për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe për furnizimin materialo-teknik të stacioneve zjarrfikëse;

j) merr masa organizative e teknike dhe planifikon fonde financiare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin edhe në projektet e veprave që hartohen dhe miratohen nga ana e tyre.

Dhe **Ligji Nr.9900, datë 10.4.2008 "Për Rezervat Materiale të Shtetit"** parashikon rolin e Kryetarit të Bashkisë me nismën e të cilit kryhet lëvrimi i mallrave në rastin kur, për kohëzgjatje të gjendjes së emergjencës civile vendore, vlerësohet i pamundur përballimi i situatës së krijuar me mallrat ndihmë humanitare.

Ligj nr.9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor", në nenin 6 parashikon se buxheti vendor përfshin një fond rezervë dhe një fond kontingjence, të pashpërndarë, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore në vendimin e buxhetit vjetor, deri në masën 3 për qind të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara.



SEKSIONI 1:

ZHVILLIMI I PROGRAMIT TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCAVE BASHKIAKE

Menaxhimi i Emergjencave përbëhet nga katër faza të ndryshme, por që ndërthuren pashmangshmërisht me njëra-tjetrën. Këto faza janë parandalimi, përgatitja/gatishmëria, përbalimi/ veprimi dhe riaftësimi.

- **Faza e parë e parandalimit** ka të bëjë me identifikimin e rrezikut potencial në zona të caktuara, përgatitjen dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese të këtij rreziku të identifikuar. Këto masa do të shërbejnë për të zvogëluar ose eliminuar rrezikun dhe ndikimin e mundshëm në komunitet. Vlerësimi i rrezikut potencial kryhet përmes analizës sasiore e cilësore të natyrës dhe të rrethanave të tjera për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera. Sipas legjislacionit shqiptar, parandalimi nënkupton një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmangien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja. Po ashtu, parashikimi nënkupton veprimtaritë që kryen për studimin dhe përcaktimin e shkaqeve të emergjencave, për përcaktimin e zonave, të territoreve dhe objekteve nga rreziqet e njëjta.



- Aktivitetet e kryera **gjatë fazës së dytë të përgatitjes/gatishmërisë** lidhen me trajnimin cilësor dhe sasior jo vetëm të strukturave përkatëse të bashkisë por dhe të këshillit apo strukturave të tjera. Gjithashtu, në këtë fazë kryhet dhe identifikimi i burimeve të nevojshme dhe mënyrat si do të përdoren këto burime. Në këtë fazë, përgatiten masat mbrojtëse që janë masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.
- **Faza tretë e përballimit** përfshin tërësinë e veprimeve të bashkisë, subjekteve të tjera publike e private dhe të komunitetit për të përballuar një rrezik aktual apo një situatë prezente të emergjencës civile vendore. Operacionet e ndërmarra në këtë fazë janë veprimet e forcave dhe të mjeteve, për shpëtimin e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë dhe të vlerave materiale (pronës) në një territor të prekur nga fatkeqësia, si dhe sigurimi i kushteve për jetesë të popullatës të prekur nga fatkeqësia.
- **Faza e katërt e riaftësimit** përfshin përpjekjet e komunitetit dhe banorëve për t'u kthyer në normalitet. Me riaftësim do të kuptojmë masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme në rajonin (territorin) e prekur nga fatkeqësia.



Përgjegjësia për shëndetin dhe mirëqenien e banorëve të bashkisë është përgjegjësi e të zgjedhurve vendorë dhe administratës së bashkisë. Çdo bashki duhet të përgatitet, brenda kompetencave të veta dhe burimeve në dispozicion për të përballuar rreziqet që mund të lindin nga një emergjencë civile në territorin e saj.

AKTIVITETE TË MENAXHIMIT TË EMERGJENCEVE CIVILE NË NIVEL BASHKIAK PËRFSHIJNË:

- Hartimin dhe miratimin e një plani efektiv të menaxhimit të emergjencave – urdhëra dhe vendime të bashkisë; publikimi në faqen e internetit të bashkisë të këtij plani;
- ngritja dhe funksionimi në vazhdimësi i strukturave bashkiake për përballimin e emergjencës;
- kryerjen e vlerësimit të rrezikut nga kërcënimet e mundshme të komunitetit;
- azhurnimi dhe testimi i planit të emergjencave në përshtatje të ndryshimeve që ndodhin me përmirësimin apo përkeqsimin e infrastrukturës;
- kryerja e trajnimeve të menaxhimit të emergjencave civile, hartimi i programeve të ndërgjegjësimit dhe edukimit për komunitetin; dhe
- menaxhimi dhe vendimmarrja gjatë një situatë emergjente.



Pse duhet plani bashkiak i Emergjencës?

Qytetarët presin nga bashkia e tyre që ajo të reagojë në mënyrë efektive dhe të koordinuar ndaj situatave emergjente duke minimizuar çdo dëmtim ose humbje për njerëzit, pronën ose mjedisin. Kjo përgjigje do të jetë e mundur vetëm me një planifikim paraprak.

Kur ndodh një emergjencë në komunitet, policia, zjarrfikësit dhe/ose personeli i ambulancës janë gjithmonë në gatishmëri për tu përgjigjur. Por a mjafton kjo? Kur emergjenca përshkallëzohet përtej kapacitetit të këtyre strukturave, bashkia duhet të aktivizojë personel dhe burime të tjera shtesë për zgjidhjen e situatës.

Hartimi i një plani për emergjencat civile do të ndihmojë në ndarjen e roleve dhe përgjegjësisë, do të ofrojë udhëzime për personat përgjegjës për zgjidhjen e këtyre situatave, do të përcaktojë rolet dhe detyrat përkatëse, do të identifikojë burimet dhe kontaktet e emergjencës dhe do të përshkruajë operacionet e shpëtimit dhe evakuimit gjatë një emergjence. Në seksionet e mëposhtme do të qartësojmë hapat për hartimin dhe zbatimin e një plani të emergjencave civile.

Vlerësimi i Rrezikut

Aktivitetet e duhura të parandalimit dhe parashikimit mund të kryhen vetëm pasi të jenë identifikuar rreziqet e mundshme dhe kur ato të vlerësohen dhe trajtohen në mënyrën e duhur. Proçesi i kryerjes së vlerësimit



të rrezikut bazohet në një shqyrtim dhe analizim i të karakteristikave të tilla si vendndodhja, intensiteti, frekuenca, probabiliteti dhe potenciali i ndikimeve fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, ndjeshmërisë dhe ekspozimit, duke marrë parasysh kapacitetin e bashkisë.

Vlerësimi i rrezikut është themeli për hartimin e planeve të emergjencës. Megjithatë, kryerja e kësaj analize të vlerësimit të rrishtit mund të kërkojë njohuri të specializuara të cilat bashkitë mund t'i përfitojnë nga diskutimet në një nivel më të gjerë rajonal e kombëtar me agjencitë e tjera partnere, bashkitë fqinje apo Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Drejtoria/ sektori e emergjencave civile në bashki duhet të ndjekë këtë proces. Por kjo strukturë duhet të ngrihet, të funksionojë rregullisht dhe në mënyrë të përhershme jo vetëm në kohë të emergjencave. Kjo strukturë duhet të mbështetet me mjetet e duhura financiare.

Për të siguruar një program gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave duhet të përfshihen të gjithë komponentët e mëposhtëm. Secili komponent duhet të zhvillohet sipas nevojave të bashkisë tuaj, burimeve apo rrethanave specifike.

Bashkëpunoni me Drejtorinë/ sektorin e emergjencave civile për përgatitjen e planit

Hartimi i një plani për përballimin e emergjencave është një proces menaxhimi që përdoret për të identifikuar vështirësitë e mundshme dhe brenda institucionit



të bashkisë, eliminimin e këtyre vështirësive duke përbushur kështu ofrimin e shërbimit në vazhdimësi dhe gjatë kohës së një emergjence civile.

Ky plan do të duhet të parashikojë mënyrat e mjete për të adresuar humbjen pjesore ose të përgjithshme të aftësive të saj operacionale, siç mund të jenë stafi ose pajisjet që duhet të shërbejnë në çdo kohë.

Për shkak se përballimi i një emergjence varet nga drejtuesit vendorë dhe administrata, po ashtu dhe nga teknologjia, apo kushtet gjeografike, ky plan duhet të përfshijë të gjithë institucionin nga kryetari e këshilli deri tek specialistët duke parashikuar saktësisht dhe zinxhirin e funksionimit dhe organizimit.

Bashkëpunimi dhe integrimi i planit të emergjencës së bashkisë me organizata të tjera

Në programin gjithëpërfshirës të menaxhimit të emergjencave bashkiake ka rëndësi përfshirja dhe integrimi i planeve emergjente të organizatave të tjera. Ky seksion i planit përfshin informacionin e planifikimit dhe operimit për organizata apo subjekte fizikë që mund të kenë një rol kyç në një emergjencë. Kjo mund të përfshijë agjenci joqeveritare si Kryqi i Kuq apo organizata të tjera humanitare me veprimtari në nivel bashkiak, rajonal, kombëtar apo bashkitë fqinje.

Plani i Evakuimit

Çdo bashki duhet të ketë një plan evakuimi si një dokument plotësues për planin e menaxhimit të



emergjencave bashkiake. Emergjencat e papritura si p.sh. prania e lëndëve/mallrave të rrezikshme, zjarret në pyje ose përmbytje të shkaktuara (kujto - rasti Shkodër, Vau Dejës, Lezhë, Fier dhe Vlorë ndër vite) mund të kërkojnë që bashkia të evakujë banorët shpejt dhe për një periudhë të zgjatur kohe.

Është shumë më e lehtë të planifikoni se si do të vazhdoni me evakuimin para se të ndodhë emergjenca sesa të prisni që të planifikoni atë sapo të ndodhë.



SEKSIONI 2:

HAPAT DHE PROÇESI PËR TË SHKRUAR NJË PLAN

Kryetari dhe këshilli bashkiak janë përgjegjës për të siguruar që bashkia e tyre të zhvillojë dhe të zbatojë një program të menaxhimit të emergjencave bashkiake. Plani duhet të jetë i mirëmenduar, studiuar dhe praktikuar për të siguruar efektivitetin dhe përshtatjen maksimale. Përveç kësaj, plani i menaxhimit të emergjencave duhet të përditësohet në baza vjetore për të siguruar që burimet e listuara dhe kontaktet janë aktuale dhe të sakta.

10 hapat për të zhvilluar një plan efektiv të reagimit në emergjencë.

Qëllimi i proçesit të planifikimit është të prodhojë një vlerësim real të rreziqeve me të cilat ballafaqohet komuniteti juaj dhe të zhvillojë një program për përgjigje emergjente për të përballuar efektivisht këto rreziqe. Kjo gjithashtu do të ju mundësojë që të përballoni në mënyrë efektive rreziqet e tjera që ju nuk i keni parashikuar.

Hapi 1: Diskutimi, trajtimi dhe vendimi i këshillit bashkiak

Proçesi i hartimit të një plani emergjence fillon dhe mbaron me këshillin bashkiak. Këshilli duhet të



mbështesë idenë e planifikimit të emergjencave, të sigurojë fonde, dhe të miratojë anëtarët e komisionit vendor të emergjencave. Këshilli i jep këtij komisioni të planifikimit autoritetin nëpërmjet një vendimi të këshillit bashkiak për të mbikqyrur procesin e hartimit të planit të emergjencave.

Këshilli bashkiak duhet të përfshihet në pika të ndryshme të procesit të planifikimit, si për tu informuar lidhur me përmbajtjen e planit dhe për të ofruar mbështetje për drejtorinë/sectorin e emergjencave në bashki.

Gjatë një situatë emergjente apo në zbatim të planit, Këshilli i Bashkisë ndërmerr këto veprime:

- Krijimin e një komisioni për menaxhimin e emergjencave duke përfshirë të paktën dy anëtarë të këshillit;
- Miratimin e Rregullores së Brendshme, e cila përfshin dhe strukturën organizative të drejtorisë/sectorit të emergjencave vendore;
- Miratimin e fondeve për shpenzimet e jashtëzakonshme të bëra gjatë një emergjence.

Këto vendime duhet të publikohen sipas Ligjit për Informimin.



Hapi 2. *Formimi i një komisioni të përhershëm të këshillit*

Këshilli bashkiak duhet të emërojë dy ose më shumë anëtarë të këshillit në një komision të përhershëm, i cili do të shërbejë si ekzekutiv në një situatë emergjente dhe do të përfaqësojë shqetësimet aktuale në planifikimin e emergjencës. Komisioni përhershëm do të mbajë lidhje me koordinatorin e menaxhimit të emergjencave në lidhje me çështjet e planifikimit dhe kërcënimet emergjente në zonë. Ky komision i përhershëm gjithashtu do të diskutojë çdo marrëveshje që i sjellë kryetari/kryetarja lidhur me ndihmat reciproke në dhe me bashkitë ose organizatat e tjera.

Hapi 3. *Koordinatori i Menaxhimit të Emergjencave dhe Komisioni për Planifikimin e Menaxhimit të Emergjencave*

Komisioni i përhershëm i këshillit duhet të emërojë Koordinatorin e Menaxhimit të Emergjencave Bashkiake, i cili ka mbështetjen e punonjësve bashkiakë, administratorëve dhe përfaqësuesve nga agjensitë që marrin pjesë në proceset e planifikimit emergjent.

Koordinatori (me kapacitet për njohjen e përgjegjësve primarë të emergjencave) do të motivojë, bashkojë dhe koordinojë një emergjencë në bashki. Koordinatori duhet të ketë autoritetin e deleguar nga bashkia për të koordinuar një emergjencë në emër të bashkisë.



Kjo mund të përfshijë autorizimin financiar për të bërë blerje dhe për të zotëruar burime. Ai do të veprojë si kryetar i komisionit të planifikimit të menaxhimit të emergjencave. Ky komision mund të përfshijë përfaqësues nga organizatat e jashtme të cilat do të marrin pjesë në emergjencat bashkiake, përfshirë personat nga:

- Drejtorja e Policisë;
- Departamenti i zjarrfikësve;
- Ambulanca / Qendra Shëndetësore / Drejtoritë arsimore;
- Administrata bashkiake/Njësitë Administrative/Administratorët e lagjeve/kryetarët e fshatrave;
- Ndërmarrjet publike bashkiake, ujësjellësat;
- Shërbimet vullnetare si dhe struktura të tjera siç e kërkon ngjarja.

Anëtarët e komisionit duhet të kenë përvojë në fushat e tyre përkatëse, të kenë njohuri të mjaftueshme të roleve të tyre, procedurave dhe burimeve të tyre operacionale dhe të kenë autoritetin për të marrë vendime në emër të institucionit së tyre.

Shmangni një komision më shumë anëtarë. Do të ishte më mirë të ngrihej një grup mbështetës për të ofruar ekspertizë dhe ndihmë për tema të veçanta sipas nevojës. Ky grup mbështetës mund të përfshijë përfaqësues nga:



- Biznese, kompani dhe shërbimet private;
- Shkollat/Konviktet;
- Zyrat/agjensitë qeveritare rajonale;
- Organizatat vullnetare dhe media lokale;
- Kompanitë e transportit dhe furnizuesit e pajisjeve/ materialeve;
- Palët e tjera të interesuara ose që kërkojnë të kontribuojnë.

Komisioni i planifikimit të menaxhimit të emergjencave do t'i raportojë komisionit të përhershëm nëpërmjet koordinatorit të menaxhimit të emergjencave. Ky i fundit duhet të raportojë në mënyrë periodike komisionit të përhershëm për të siguruar mbështetjen e vazhdueshme dhe miratimin e veprimeve, planeve ose procedurave dhe vendimeve.

Duhen mbajtur parasysh se ndikimet nga një emergjencë mund të tjekalojnë juridiksionin territorial të një bashkie. Për shembull, një departament zjarrfikësesh mund t'i shërbejë disa bashkive. Gjatë një situatë emergjente që përfshin disa bashki, shtrirja e shërbimeve lokale mund të kërkojë një nivel të lartë koordinimi, krahasuar me një emergjencë të izoluar lokale që mund të ndikojë vetëm një bashki.

Shqyrtoni modelin e planit të emergjencës për t'u njohur me përmbajtjen e tij, për të kuptuar rolet dhe përgjegjësitë dhe për tu njohur me operacionet e nevojshme për menaxhimin e një emergjence.



Hapi 4. Cakto qartë rolin dhe përgjegjësitë e Drejtorisë/Sektorit të Emergjencave Civile në Bashki

Plani është një projekt për t'ju përgjigjur emergjencave. Një pjesë e zhvillimit të projektit përfshin dhënien e roleve dhe përgjegjësiave grupeve ose individëve të caktuar për aspekte të ndryshme të planifikimit ose reagimit emergjent. Caktoni këto përgjegjësi në bashkëpunim me individët ose grupet të cilët do t'i kryejnë ato për të siguruar pajtueshmëri dhe kuptim të qartë të roleve.

Hapi 5: Kryej vlerësimin e rrezikut

Planifikimi i emergjencës përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve me të cilat përballet komuniteti juaj. Përmes hulumtimeve, të dhënave shkencore, rekordeve historike, njohurive lokale etj. ju mund të kuptoni kërcënimet potenciale me të cilat ballafaqohet zona/rajoni juaj dhe disa efekte të mundshme të një emergjence.

- ◆ *Jini realistë. Qëllimi nuk është që të parashikohet çdo rrezik i mundshëm, por të zhvillohen procedura sistematike që sigurojnë një përgjigje efektive ndaj një emergjence të mundshme dhe jo aq të mundshme.*

Mbani në mend pyetjen: Çfarë do të bëjmë nëse ...? Në çdo komunitet ka rreziqe specifike dhe qëllimi është identifikimi i këtyre rreziqeve dhe ofrimi i shërbimeve për parandalimin e tyre apo eliminimin e pasojave.



Vlerësimi i Rrezikut është i dobishëm për zhvillimin e një skeme për të gjithë ata që marrin pjesë në një nevojë emergjente. Është sasia e pritshme e dëmit që përcakton nivelin e efekteve negative mbi jetesën e një popullsie ose pronat e saj pas ekspozimit ndaj një dukurie të mundshme rreziku. Përbërësit kryesorë të vlerësimit të një rreziku përfshijnë identifikimin e dukurisë së mundshme të rrezikut dhe një analizë që u përgjigjet këtyre pyetjeve:

- ◆ *Cilat janë dukuritë e mundshme të rrezikut që mund të çënojnë një komunitet?*
- ◆ *Çfarë mund të ndodhë si rezultat i këtyre dukurive?*
- ◆ *Sa të ngjarë ka të ndodhë secili nga rreziqet e mundshme?*
- ◆ *Nëse ngjarjet ndodhin, cilat do të jenë rezultatet dhe humbjet?*

Konsideroni të gjitha burimet e mundshme që ka bashkia juaj në dispozicion dhe ku mund të furnizoheni me artikuj, mallra e materiale që nuk i keni në dispozicion ose mund të jenë të kufizuara në treg. Nëse përballeni me mungesë të burimeve ose personelit të kualifikuar për të kryer funksionet e nevojshme në raste urgjente, bashkia mund të miratojë një marrëveshje të ndihmës reciproke ose një marrëveshje bashkëpunimi ose mirëkuptimi me një bashki tjetër ose organizatë tjetër që ka kapacitetin ose aftësinë e kërkuar për të siguruar kushtet e domosdoshme të dhënies së ndihmës në rast të një emergjence.



- ◆ *Drejtoria/sektori e emergjencave civile në bashki mund dhe duhet të kryejë vlerësimin e rrezikut për bashkinë tuaj.*

Hapi 6. Përcaktoni burime për të cilat keni nevojë

- ◆ *Programi i menaxhimit të emergjencave bashkiake është po aq i efektshëm sa aftësia e bashkisë për ta zbatuar atë.*

Një përgjigje efektive emergjente përfshin dy komponentë:

- Vlerësimin e shpejtë të situatës së emergjencës dhe reagimin e shpejtë, dhe
 - Përdorimin e mirë të burimeve ekzistuese në bashki.
- ◆ *Plani është në thelb një projekt për një reagim emergjent.*

Kryetari i bashkisë krijon dhe mban një regjistër për specialistët në territorin e bashkisë, me të cilin këshillohet kur është e nevojshme. Përditësoni këtë listë me dosjet e të gjithë personelit të nevojshëm, duke përfshirë anëtarët e këshillit, përgjegjësit kryesorë dhe personat përgjegjës për bazën materiale të nevojshme.

Kjo listë duhet të përfshihet si një shtojcë në planin kryesor. Kjo listë duhet të përmbajë dhe burime alternative të mallrave apo shërbimeve që mund t'ju nevojiten në raste urgjence.



Plani duhet të përmbajë një sistem njoftimi e komunikimi, i cili përshkruan se kush nis njoftimin dhe se si do të vazhdojë më tej. Një procedurë e caktuar informimi do të sigurojë të gjithë personelin e nevojshëm dhe burimet të kontaktohen për t'ju përgjigjur emergjencës.

Konsideroni sa vijon:

- A mund t'i përgjigjeni më shumë se një emergjence në një kohë?
- Ku mund të gjeni njerëz shtesë dhe pajisje shtesë nëse është e nevojshme?
- A keni sistem të besueshëm të komunikimit dhe transportit në vend?

Hapi 7. Hartoni Planin e Emergjencave

Sapo të gjitha pozicionet të plotësohen dhe burimet të identifikohen, është koha për të bashkuar të gjithë materialet në një pikë të vetme. Ndarja e punës së identifikimit të burimeve me anëtarët e Komisionit të Planifikimit të Menaxhimit të Emergjencave do ta bëjë këtë proces shumë më të lehtë për drejtorinë/ sektorin përkatës. Para paraqitjes së planit në Këshill për miratim, organizoni të gjithë informacionin duke e përpiluar në një dokument, për një prezantim dhe organizim më të mirë.

Do të jetë Drejtoria/Sektori e Emergjencave Civile ajo që do të paraqesë planin për miratim në këshill. Këshilli mund ta miratojë atë siç është ose të sugjerojë disa



ndryshime. Nëse nevojiten ndryshime, do të bëhen rishikimet e nevojshme dhe të riparqiten të plota në këshill. Këto hapa mund të përsëriten deri në miratimin e këshillit. Sapo të miratohet ajo duhet të nënshkruhet dhe të vihet data e nënshkrimit.

Ky plan duhet t'i përcillet të gjitha strukturave të interesuara si agjensive partnere, zyrës së prefektit, zyrave përkatëse në bashki, Komiteti i Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Krizave (në vijim "KKECK") pranë Këshillit të Ministrave, Sektorit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin - MZSH-së, Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave, Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, policisë, shkollave, qendrave shëndetësore, ndërmarrjeve, etj.

Hapi 8: Trajnimi

Stafi i Drejtorisë/sektori të Emergjencave duhet të njohë mirë rolet e përgjegjësitë e tyre dhe të jenë të përgatitur për të ofruar udhëzime për stafin ose vullnetarët të cilët gjithashtu mund të jenë pjesë e ekipit të reagimit. Kjo strukturë në bashki ofron një sërë programesh trajnimi për menaxhimin e emergjencave bazë dhe të avancuara.

Hapi 9. Testoni planin

Testoni planin tuaj, pjesërisht dhe tërësisht. Testimi i planit të emergjencës është po aq i rëndësishëm sa dhe shkrimi i planit. Ushtrimet mund të jenë stërvitje të vogla, diskutime apo ushtrime në shkallë të gjerë. Një ushtrim emergjence nuk ka për qëllim të testojë



përgjegjësit, por shërben si një mjet për të qartësuar të gjithë personat e përfshirë. Ai ofron një mundësi që të gjithë të testojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre dhe të marrin në konsideratë komponentët dhe çështjet që mund të lindin papritur gjatë një emergjence.

Sigurohuni që plani juaj i emergjencës të sigurojë shpërndarjen e informacionit tek publiku gjatë një emergjence.

Përfundoni ushtrimin me një sesion informimi.

Gjithkush që ka marrë pjesë në testim duhet të marrë pjesë në sesionin e informimit. Kjo është një mundësi për të gjithë që të ndajnë perspektivat e tyre dhe të ofrojnë reagime pozitive dhe negative.

Zyrtarët ose vlerësuesit e sigurisë publike duhet të japin mendime mbi ushtrimin, duke u fokusuar veçanërisht në efektivitetin e planit dhe koordinimin e personelit, resurseve dhe ngjarjeve. Është e mundshme që stërvitja të nxjerrë në pah disa fusha në planin tuaj të emergjencës që kërkojnë rishikim. Bëni rishikimet e duhura bazuar në vëzhgimet e ushtrimit. Në mënyrë ideale, mund të ndërmerri disa testime të njëpasnjëshme.

Hapi 10. *Përditësimi i Planit dhe Informimi i Qytetarëve*

Plani duhet të rivlerësohet dhe përditësohet çdo vit. Burimet dhe kontaktet shpesh ndryshojnë dhe zëvendësimi i shpejtë i tyre do të shmangë sfidat gjatë një përbalimit të një situatë emergjente. Nëpërmjet



planifikimit dhe testimit të vazhdueshëm, do të sigurohet dhe ndërgjegjësimi i duhur që vetë personat apo strukturat e përfshira të përditësojnë të dhënat për kontaktet e tyre. Tashmë ka mjaft programe të thjeshta elektronike që mundësojnë mbledhjen e të dhënave e rrjedhimisht dhe përditësimin e planit të emergjencës.

Ndërgjegjësimi dhe mbështetja e qytetarëve janë elemente kritike në planifikimin dhe përballimin e emergjencave. Kryeni konsultime publike gjatë fazës së planifikimit. Përfaqësuesit e organizatave ose agjensive të tjera, vullnetarëve dhe qytetarëve mund të ofrojnë rekomandime apo të identifikojnë probleme të mundshme që ju nuk i keni konsideruar.

◀▶ *"Ndërgjegjësimi dhe mbështetja e publikut janë elemente kritike në planifikimin e emergjencave".*

Ndani planin e emergjencës me të gjithë ata që mund të luajnë një rol në përballimin e emergjencave. Takohuni me përfaqësuesit e departamenteve dhe agjensive pjesëmarrëse për t'i informuar ata dhe për t'ju përgjigjur çdo pyetjeje në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre në një situatë emergjence.

Konsultohuni me Drejtorinë / sektorin e Emergjencave Civile në Bashki

Këshilli i Bashkisë ose Kryetari mund ti kërkojë Drejtorisë/sektorit të Emergjencave Civile në bashki çështjet si vijojnë:



- Burime emergjente për t'iu përgjigjur një emergjence të veçantë nëse këto burime nuk janë në dispozicion të bashkisë suaj ose kapërcejnë mudësitë tuaja.
 - Asistencë, qoftë dhe e jashtme që plani i emergjencave të jetë gjithpërfshirës si edhe organizimin e takimeve mes drejtorisë/sektorit dhe këshillit.
 - Trajnimi në menaxhimin bazë të emergjencave, testimi i planit dhe stërvitja, si dhe menaxhimin e avancuar të emergjencave.
- ◆ *"Gatishmëria ndaj emergjencave është një aktivitet i vazhdueshëm; shkruani planin tuaj dhe ushtrohuni!"*

Planifikimi i kontigjencës

Planet e kontigjencës janë masa për emergjencat specifike që janë të papaparashikuara dhe nga vlerësimi i rrezikut. Merrni parasysh si vijon:

- Cilat agjensi/organizata duhet të përfshihen?
- Cili është roli i veçantë për çdo agjensi/organizatë?
- Çfarë burimesh nevojiten për të trajtuar një emergjencë të tillë?
- Çfarë nevojash ose personel i kualifikuar nevojitet për t'ju përgjigjur në mënyrë efektive?



- Si mund të sigurohen këto burime dhe ky personel?
- Në qoftë se personeli apo burimet nuk janë në dispozicion në nivel lokal, cilat bashki, institucione apo organizata të tjera kanë këto pajisje ose aftësi të specializuara?

Komunikimi dhe Informimi

Planifikoni që informimi duhet kryer brenda 24 - 72 orëve të fazës pas emergjencës. I gjithë personeli duhet të njoftohet. Kjo mund të ndodhë në mënyra të ndryshme.

'Informimi duhet të përfshihet në planin e emergjencës për të mundësuar diskutimin dhe vlerësimin e përballimit të emergjencës ... "

Informimi duhet të përfshijë:

- Një vlerësim objektiv i emergjencës dhe veprimeve të ndërmarra;
- Vështirësitë që hasin individët ose grupet (p.sh. komunikimin, keqkuptimin e rolit të dikujt, etj);
- Ndryshimet e rekomanduara për programin e menaxhimit të emergjencave vendore;
- Komentet e secilit individ.

Informimi është një proces i dobishëm që lejon pjesëmarrësit të shprehin shqetësimet dhe ankthet e përjetuara gjatë emergjencës. Dështimi për të adresuar këto ndjenja mund të rezultojë në rritjen e



simptomave të stresit. Pa një informim të duhur, këto simptoma mund të bëhen të dukshme menjëherë pas emergjencës dhe mund të zgjasin me vite. Për disa individë, edhe stërviçjet emergjente mund të jenë stresuese.

- ◆ *Është e rëndësishme që të gjithë të marrin pushim sasior dhe cilësor gjatë dhe pas një emergjence.*

Shërbimet e emergjencës përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit.

- ◆ *Si rregull i përgjithshëm, emergjencat janë të paparashikueshme.*

Kjo e bën pothuajse të pamundur të sigurohen të gjitha burimet e nevojshme apo që personeli i kualifikuar të jetë gjithmonë i disponueshëm kur ndodh një emergjencë.

Sidoqoftë, këta persona ose mjete shpesh janë jetësore për një përballim efektiv dhe të koordinuar. Një mënyrë për t'iu qasur shpejt burimeve, aseteve dhe personelit të kualifikuar në raste urgjente janë marrëveshjet me organizatat lokale ose bashkitë fqinje. Në marrëveshje parashikoni rolet dhe përgjegjësitë e bashkisë dhe palës tjetër në ofrimin e shërbimeve shtesë, si para dhe gjatë përballimit të një situatë emergjente.

Marrëveshja mund të bëhet me institucionet/subjekte të ndryshme për burimet dhe nevojat e mëposhtme si psh:



- Drejtoritë Arsimore - për përdorimin e objekteve shkollore dhe pajisjeve të tjera në rast se është i nevojshëm evakuimi dhe duhet të krijohet një qendër pritjeje;
- Kompanitë transportit për përdorimin e autobusëve për evakuim;
- Bashkitë fqinje për pajisje të specializuara, personel shtesë dhe / lehtësues / makineri / mjete zjarrëfikëse / pompa / mjete lundruese etj;
- Organizatat e shërbimeve të komunitetit / organizata humanitare për të ofruar shërbime mbështetëse siç janë shërbimet ushqimore ose përdorimi i qendrave private të komunitetit.

Sipas Kreut V, nenit 14, të ligjit 139/2015: Për kryerjen e funksioneve dhe ofrimin e shërbimeve specifike në dobinë e përbashkët, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, mund të ushtrojnë së bashku çdo funksion dhe/ose shërbim që u është dhënë atyre me ligj, nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ose kontratave të përbashkëta, delegimit të kompetencave dhe përgjegjësive të veçanta njëra-tjetrës ose kontraktimit me një palë të tretë.

Në çdo marrëveshje të bashkëpunimit ndërvendor përcaktohen:

- a) qëllimi i marrëveshjes;



- b) funksionet që do të ushtrohen nga secila bashki apo në mënyrë të përbashkët;
- c) mënyra me anë të së cilës do të plotësohet qëllimi;
- ç) shkalla dhe kohëzgjatja e delegimit të kompetencave;
- d) mënyra dhe masa e kontributit financiar përkatës dhe e ndarjes së të ardhurave e të përfitimeve të tjera.

Modeli gjendet në shtojcën e këtij dokumenti.

Hartimi i Planit të Evakuimit

Në hartimin e një plani për evakumin e banorëve dhe gjësë së gjallë duhet pasur parasysh:

- Mbrojtja e popullsisë/banorëve: A është evakuimi e vetmja mënyrë për t'i mbrojtur ata nga dëmet?
- Trajnime në bashki: Kush duhet të trajnohet? Çfarë temash duhet të trajtohen?
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në evakuim: Cilën metodë të edukimit publik ka bashkia juaj për t'i informuar ata për këto pyetje?
- Njoftimi publik: Si do t'i njoftoni banorët se duhet të largohen nga zona? Ku do t'i dërgoni?
- Drejtoria/sektori e emergjencave në bashki: Cilat karakteristika unike kanë banorët e zonës së prekur si dallime kulturore dhe gjuhësore?
- Nevoja të specializuara: Çfarë nevojash të veçanta



kanë njerëzit në zonën e prekur (p.sh., aftësitë e kufizuara, transportin, kafshët shtëpiake, blegtorinë)? Çfarë informacioni duhet të dinë?

- Numrat e Evakuimit: sa njerëz do të duhet të evakohen? A duhet të njoftohen të tjerët në zonë? Si do të trajtojë bashkia me anëtarë të familjeve të ndara?
- Efekti mbi qytetarët: Si do të ndikojë një evakuim në nivelin e stresit dhe aftësitë përbaluese të kombinuara me një emergjencë në shkallë të gjerë? Çfarë lloj ndihme është në dispozicion të tyre?
- Efekti mbi të tjerët: Si do të ndikojë evakuimi në bashkitë fqinje?
- Efektet në aspekte të tjera: Si do të ndikojë evakuimi në ekonominë lokale, pasojat politike dhe strukturën shoqërore të komunitetit?
- Karakteristika të zonës: Cilat pjesë të bashkisë janë veçanërisht në rrezik për të evakuar? Çfarë mund të bëhet për të zvogëluar këtë rrezik?
- Nevojat e zonës: Nëse shumë njerëz duhet të evakohen, a mundet infrastruktura bashkiake (rrugë, ura, etj.) të përballojë vëllimin e trafikut në këtë kohë?
- Autoriteti: A mund të ndodhë evakuimi vetëm kur bashkia ka shpallur gjendjen e emergjencës lokale? Kush "urdhëron" një evakuim? Cilat janë



konsideratat e përgjegjësisë? Cilat janë pasojat e këtyre detyrimeve?

- Agjensitë e përfshira: Kush e bën çfarë në evakuim?
- Faza e rikthimit: Kush do të monitorojë dhe përcaktojë kur është e sigurtë që të evakuarit të kthehen?
- Riaftësimi: Çfarë ndihme kanë të shpërngulurit të cilët përballen me dëmtime apo humbje si rezultat i emergjencës?

◆ *'Kush bën çfarë në rast të një evakuimi'-qetësi në ndarjen e detyrave, menaxho kohën dhe stresin.*

Bashkitë kanë përgjegjësi për parapërgatitjen, planifikimin dhe operacionet e përgjigjes ndaj situatave emergjente që ndodhin në territorin e tyre. Menaxhimi i emergjencave civile në bashki, bëhet në përputhje me planet e emergjencave ose planet e gatishmërisë që ato përgatitin, testojnë dhe azhurnojnë periodikisht.

Çdo bashki duhet të krijojë dhe mbajnë një sistem të:

- njoftimit në kohë dhe informimi të strukturave kyçe;
- alarmit dhe evakuimit të popullsisë;
- skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për t'u përgjigjur në raste të emergjencave civile;



- ndërmarrjes dhe administrimit të aktiviteteve të riaftësimit për zonën e prekur nga emergjenca;

\Bashkia është përgjegjëse për hartimin e masave për parandalimin, lehtësimin, përgatitjen, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave civile, si:

- sigurimin e vendstrehimeve të përkohshme të sigurta;
- vlerësimin e dëmeve dhe të nevojave bazë;
- mbajtjen e kushteve higjienike duke siguruar furnizimin me ujë, mirëmbajtjen e kanalizimeve dhe kujdesjen për viktimat;
- bashkërendimin dhe mbështetjen për grupet e kërkim-shpëtimit dhe të vullnetarëve;
- çështje të tjera që kanë për qëllim përgjigjen efektive ndaj situatës së emergjencës civile.



SEKSIONI 3:

VEPRIMTARIA E KOMISIONIT VENDOR NË SITUATA TË EMERGJENCAVE CIVILE

Udhëzimet e Planifikimit dhe Operimit

